




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA VUSHTRRI
OPSTINA VUCITRN

PROCESVERBAL

nga mbledhja e -II-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më
14 shkurt 2020 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 13:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Melihate Basholli-Latifi, Ymer Haradinaj, Gresa Muli, Shkëlzen Feka, Arta Ymeri, Teuta Aruçi Shartari dhe Nezir Klinaku (anëtarë të KPF -së).

Mungoi: Shpëtim Zhegrova.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: drejtorët e drejtorive (Lutfi Gërguri dhe Sylejman Mehulli), përfaqësues nga OSBE-ja, si dhe nga sekretaria e kuvendit: Haki Maloku, Bastri Duraku dhe Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë. Aliu tha se na kanë ardhur edhe disa propozime për t'i futur në pika të ndryshme.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa shprehën shqetësimin e tyre lidhur me mospjesëmarrjen e një pjese të madhe të drejtorëve të drejtorive në mbledhje, duke mos e marrë seriozisht punën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – propozoi që të futet në rend të ditës kërkesa e Albin (Gani) Qerimit- një nxënës me nevoja të veçanta. Ky nxënës ka arritur që t'i mësojë shkronjat në shkollë me asistenten e financuar nga familja. Tani shkolla "Ali Kelmendi" ka angazhuar një asistente, e cila i është ofruar familjes, si mundësi e vazhdimit të shkollimit të nxënësit, Albin Qerimi. Prindi i tij, Ganiu ka refuzuar që kjo asistente të punojë me fëmijën e tij, pasi që fëmija nuk po pranon asistente tjetër, tha Klinaku. Në pamundësi që prindi të paguajë asistenten që ka punuar me fëmijën e tij ka kërkuar nga komuna përkrahje financiare që ta paguajë këtë asistente.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 16 janar 2020;
2. Shqyrtimi i Informatës vjetore për gjendjen në shëndetësi për vitin 2019;
3. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2019/2020;
4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me raportimet kundër korrupsionit;

5. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2019;
6. Shqyrtimi i Informatës për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019;
7. Shqyrtimi i petitionit nga Shell Kosova – Kompania “Al Petrol” SH.P.K, lidhur me orarin e punës të kompanive të karburanteve;
8. Shqyrtimi i petitionit i përfaqësuesve të qebaptoreve të Vushtrrisë, lidhur me orarin e punës;
9. Shqyrtimi i kërkesës të përfaqësuesve të bizneseve të vogla (kiosqeve) lidhur me orarin e punës;
10. Shqyrtimi i kërkesës së Albin (Gani) Qerimit, dhe
11. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 16 janar 2020.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 12 dhjetor 2019.

2. Shqyrtimi i Informatës vjetore për gjendjen në shëndetësi për vitin 2019.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – përgëzoi stafin dhe drejtorin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për një informatë të mirë.

Në bazë të informatës po del që numri i pacientëve po rritet çdo vit. Ai pyeti drejtorin se cila është arsyeja e rritjes së numrit të pacientëve, gjendja e rëndë shëndetësore, apo shërbimet më të mira dhe efikase?

Sylejman Mehulli, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale– deklaroi se është e vërtetë që po rritet numri i pacientëve në kujdesin parësor. Ai tha se ka ndikuar rritja e besimit të qytetarëve në shërbimin e kujdesit parësor, po ashtu kanë ndikuar edhe disa shërbime të reja që janë bërë funksionale etj.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së- tha se në Asociacionin e Komunave është biseduar për mbetjet medicinale si një problem shqetësues për qytetarët. Ai pyeti drejtorin se si trajtohen këto mbetje në komunën tonë?

Sylejman Mehulli, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale– tha se sipas ligjit, mbetjet medicinale kanë një trajtim të veçantë, në mënyrë që mos të rrezikohet shëndeti i qytetarëve. Ai tha se secili regjion e ka një qendër ku bëhet shkatërrimi i tyre. Fatmirësisht, në komunën tonë bëhet shkatërrimi edhe në spitalin e Vushtrrisë, ku falë një bashkëpunimi të mirë që kemi krijuar, mbetjet medicinale të kujdesit parësor shkatërrohen këtu në spital. Ai tha se nga ky vit kemi planifikuar mjete financiare për një gjë të tillë, në mënyrë që mos t'i bëhemi ngarkesë spitalit. Pra, përmes kontratës do ta kryejmë këtë shërbim me pagesë.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

3. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2019/2020.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – tha se disa shkolla ende nuk kanë emra. Ai kërkoi informatë me shkrim nga Drejtoria për Arsim se a është iniciuar procedura lidhur me emërtimet e këtyre shkollave pa emra?

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me raportimet kundër korrupsionit.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

5. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2019.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

6. Shqyrtimi i Informatës për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – paraqiti si shqetësim problemin e qenve endacakë. Ai tha se në komunën tonë është arritur që t'iu sigurohet edhe ushqim qenve endacakë. Klinaku shtoi se në sheshin "Hasan Prishtina" është rritur numri i qenve endacakë. Ai kërkoi informatë se a është bërë ndonjë studim lidhur me vendosjen e enëve metalike për ushqim të qenve endacakë në sheshin "Hasan Prishtina", meqë si shkak i saj po shihet grumbullim i madh i qenve endacakë, ku po vërehet rrezik për qytetarët!

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

7. Shqyrtimi i petitionit nga Shell Kosova – Kompania "Al Petrol" SH.P.K, lidhur me orarin e punës të kompanive të karburanteve.
8. Shqyrtimi i petitionit i përfaqësuesve të qebaptoreve të Vushtrrisë, lidhur me orarin e punës.
9. Shqyrtimi i kërkesës së përfaqësuesve të bizneseve të vogla (kiosqeve) lidhur me orarin e punës.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – theksoi se atë ditë kur është aprovuar Rregullorja për orarin e punës të bizneseve kemi thënë që është sjellë me nguti, po del që kemi pasur të drejtë, sepse më mirë do të ishte që të shtyhet afati për hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje në mënyrë që të analizohet më në detaje gjendja dhe të merren përvoja nga shtetet e rajonit dhe Evropës.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se i kam paraqitur vërejtjet e mia atë ditë kur është aprovuar Rregullorja për orarin e punës së bizneseve. Fatkeqësisht doli në shesh ajo se, nënkryetari i Komunës së Mitrovicës në një emision televiziv tha se e falënderon Kuvendin

Komunal të Vushtrrisë që na përkrahu për miratimin e rregullores në fjalë. Kam deklaruar se niveli qendror duhet ta miratojë një rregullore të tillë, sepse nuk është në rregull që në një komunë mos të punohet e komuna tjetër që është afër të punojnë bizneset. Konsideroj që kjo rregullore është kopjuar nga Mitrovica dhe se mendoj që janë ngatërruar kompetencat e nivelit qendror me nivelin lokal. Edhe unë pajtohem që kjo rregullore ka ardhur me nguti dhe nuk është bërë ndonjë studim i gjendjes.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – do të ishte mirë që dikush nga zyra ligjore të ishte i pranishëm dhe të na tregojë se si mund ta ndryshojmë tash këtë rregullore. E jo të na vijnë në çdo seancë peticione të ndryshme për shqyrtimin e rregullores. Ne si jurist e dimë se çka është e vështirë të bëhet diçka praktike dhe sa është e lehtë të vendoset diçka në letër. Prandaj, sfida e kemi se si të gjejë zbatim kjo rregullore. Prandaj, duhet ta gjejmë një model që kjo rregullore të jetë funksionale dhe e qëndrueshme.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

10. Shqyrtimi i kërkesës së Albin (Gani) Qerimi.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se sikur të ishte prindi i tij me nevoja normale do të ishte në rregull të dërgohej tek ajo asistente që ia ka caktuar shkolla. Por, të dy prindërit janë persona me nevoja të veçanta, por edhe anëtarët tjerë janë me nevoja të veçanta. Do të thotë, e tërë familja pesë anëtarëshe janë persona me nevoja të veçanta. Prandaj, është mirë si kuvendi i komunës ta gjejmë një formë që ta ndihmojmë. Por, paraprkasht drejtori i Drejtorisë për Arsimit në bashkëpunim me drejtorin e shkollës para seancës së kuvendit të bisedojnë dhe të gjejnë ndonjë formë për ta ndihmuar këtë nxënësi.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – tha se ndjehet keq për gjendjen e këtij nxënësi. Por, konsideroj që nuk është kuvendi që mund t'i bëjë ndonjë zgjidhje këtij nxënësi, por Drejtoria për Arsim në bashkëpunim me Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale ndoshta kanë mundësi të gjejnë një zgjidhje.

Sylejman Mehulli, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale – deklaroi se do të ishte mirë të planifikohet ndarja e disa bursave për nxënësit me nevoja të veçanta, të ketë një numër të rezervuar për ta.

Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – tha se disa bursa ndahen për këtë kategori.

Gresa Muli, anëtare e KPF-së – kam menduar që KPF-ja është një mbledhje më serioze, pasi që kuvendi i komunës është organi më i lartë në komunë dhe se materialet procedohen në kuvend nga ky komitet. Prandaj, qeveria komunale ta marrë më seriozisht këtë komitet dhe se drejtorët e drejtorive të jenë prezent në mbledhjet e këtij komiteti.

Ajo tha se ndjen keqardhje për rastin në fjalë. Por, nëse e ngritim si rast në kuvend, atëherë kemi edhe 120 raste tjera me nevoja të veçanta që e vijnë në mësim. Prandaj, më mirë është të bëhet një zgjidhje e përhershme për të gjithë.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se është e vërtetë që ka nxënës tjerë me nevoja të veçanta, por, komuna i ka pranuar tri asistente që po merren me këta nxënës. Mirëpo, ky rast është më specifik, pasi që e tërë familja janë persona me nevoja të veçanta.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – tha se duhet të gjejmë një formë për të ndihmuar nxënësin me nevoja të veçanta, për shkak të ndjeshmërisë së rastit.


11. Të ndryshme.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – tha se këto ditë një djalë i ri në Stanoc të Epërm ka bërë vetëvrasje, ku para disa muajve ky djalë e ka bërë përpjekjen e parë për të bërë vetëvrasje, por është shpëtuar. Pata kërkuar që Qendra për Punë Sociale të merret me atë rast. Ai pyeti drejtorin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale se a ka informacione se a është marrë dikush me këtë rast këta gjashtë muajt e fundit?. Ai kërkoi përsëri informatë me shkrim nga Drejtoria për Arsim, pasi theksoi se nuk ka marrë përgjigje lidhur me pyetjen se: Mbi çfarë baze u është refuzuar e drejta punëtorëve teknikë të shkollave të kompanisë “Wenda” lidhur me pagesën e përvojës së punës?. Në këtë rast, ai kërkoi përgjigje se këta punëtorë a do t'i marrin mjetet financiare nga e drejta e përvojës së punës?.

Sylejman Mehulli, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale– tha se tash e mora këtë informacion lidhur me vetëvrasjen e personit në fjalë nga Stanoci. Para disa muajve, mjekët më kanë shpjeguar rastin, ku ekipi nga urgjenca ia kanë shpëtuar jetën këtij djali. Ai tha se do të interesohet edhe në Qendrën për Punë Sociale se a kanë ofruar shërbime lidhur me këtë rast.

Mbledhja përfundoi në orën **14:20**.

Bujar Klinaku



Procesmbajtës



Nasuf Aliu

Kryesues i KK-së dhe i KPF- së